



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	19.10.2022	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shënime
09	660/01-28218	-1-



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Kaçanik, 19. 10. 2022

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve – klubeve dhe shoqatave sportive lidhur me realizimin e aktiviteteve të rregullta sportive, mbështetur në Planin e punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport -sektorit për sport për vitin 2022-Manifestimi sportiv “Sportisti i vitit 2022”

1. Komuna e Kaçanikut- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duke u bazuar në Rregulloren MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare/klubeve dhe shoqatave sportive/ të Regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në realizimin e aktiviteteve sportive.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objekt zbatimin e aktivitetit sportiv :

Manifestimi sportiv “Sportisti i vitit 2022”

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 2,000.00 euro (Euro).
4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektin është 1,000.00 € (euro) ndërsa shuma maksimale e projekti është 2,000.00 € (euro)

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 08. 11. 2022, ndërsa periudha e zbatimit të projektit është në muajin dhjetor 2022.
6. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës e të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ- të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
7. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* ëeb faqja: <https://kk.rks-gov.net/kacanik> te rubrika: **Shpalljet**
9. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në sportelin nr. 8 te objektit te komunës së Kaçanikut.
10. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
11. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: hafize.sallahi@rks-gov.net

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

